



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Politikën e Jashtme***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 26.01.2022, ora 11.30

**Drejton mbledhjen:**

**Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën kuadër “për etikën në turizëm dhe protokollin opsional të saj”.
2. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën ndërkombëtare “Për kontrollin e dëmit nga sistemet për mbrojtjen antivegetative në anije, (Antifouling) 2001”.
3. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Organizatën Hidrografike Ndërkombëtare”.

**Marrin pjesë:**

Mimi Kodheli, Etjen Xhafaj, Petro Koçi, Besion Ajazi, Blendi Klosi, Tomor Alizoti, Hatixhe Konomi, Klodiana Spahiu, Lavdrim Krrashi, Belind Këllici, Kreshnik Çollaku, Vangjel Dule, Grida Duma dhe Taulant Balla.

**Mungojnë:**

Benet Beci, Alqi Bllako, Tritan Shehu, Shpëtim Idrizi dhe Greta Bardeli.

**Të ftuar:**

Vilma Bello - Zëvendësministre e Turizmit dhe Mjedisit

Vilma Baze - Drejtore e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Turizmit

Ardi Veliu - Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Bledar Karoli - Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Transportit

Elson Thana - Specialist në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Transportit

Dallëndyshe Bici - Zëvendësministre e Mbrojtjes

Ardit Çollaku - Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Fushën e Mbrojtjes

Emërush Bejdo - Komandant i Hidrografisë në Komandën e Forcës Detare, Kapiten i Rangut të Parë

## HAPET MBLEDHJA

**Mimi Kodheli** – Mirëdita, të gjithëve!

U kërkoj ndjesë kolegëve prezentë për vonesën e fillimit të mbledhjes së komisionit!

Fillojmë pa humbur kohë mbledhjen e Komisionit të Politikave të Jashtme. Në rendin e ditës kemi: projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën kuadër “Për etikën në turizëm dhe protokollin opsional të saj”; projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën ndërkombëtare “Për kontrollin e dëmit nga sistemet për mbrojtjen antivegetative në anije, (Anti-Fouling) 2001”. Ne jemi komision për dhënie mendimi. Relatore është zonja Konomi.

Po ashtu kemi projektligjin e tretë “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Organizatën Hidrografike Ndërkombëtare”. Ne jemi komision për dhënie mendimi. Relator është kolegu Koçi.

Për projektligjin e parë të ftuar kolegen Vilma Bello, zëvendësministre e Turizmit dhe Mjedisit, dhe zonjën Baze, drejtore e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Turizmit .

Mirë se vini, zonja!

Fillojmë pa humbur kohë. Kolegia Bello, fjala për ju.

**Vilma Bello** – Faleminderit!

E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën kuadër “Për etikën në turizëm dhe protokollin opsional të saj”, propozohet si rrjedhojë e faktit që Shqipëria është një nga 159 vendet anëtare të Organizatës Botërore të Kombeve të Bashkuara për turizmin më tej në përcaktimin UNWTO.

Kjo konventë është konventa e parë e Organizatës Botërore të Kombeve të Bashkuara për Turizmin, e cila është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme UNWTO në 5 gjuhët zyrtare të saj, e miratuar në sesionin 23, të mbajtur në Shën Petersburg në shtator të vitit 2019.

Organizata Botërore e Turizmit i ka ftuar të gjitha vendet anëtare të saj të aderojnë në këtë konventë, pasi është një konventë, e cila synon të promovojë turizëm të qëndrueshëm, të besueshëm dhe të arritshëm universalisht përmes zbatimit të disa parimeve etike në turizëm dhe

u referohet të gjithë aktorëve që ndikojnë pikërisht në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe në zbatimin e parimeve etike në këtë sektor.

Dua të sjell në vëmendje të komisionit dhe anëtarëve të nderuar të tij se ky projektligj është hartuar në përputhje me programin politik të qeverisë dhe në përputhje me programin e përgjithshëm të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për nismat ligjore dhe nënligjore, që duhen ndërmarrë për përmirësimin e kuadrit ligjor, nënligjor dhe rregullator për turizmin.

Jam e bindur që kolegu dhe relatori i nderuar, zoti Klosi, do ta plotësojë edhe më tej shtjellimin e këtij informacioni.

Pjesë e kësaj konvente janë 14 shtete: Austri, Kroaci, Qipro, Çeki, zona Flamane, Greqi, Gjermani, Japoni, Maltë, Maqedoni e Veriut, Serbi, Slloveni, Spanjë dhe Zvicër.

Kjo konventë synon të promovojë një turizëm të qëndrueshëm, të besueshëm dhe të arritshëm universalisht, përmes zbatimit të parimeve etike në turizëm, duke kërkuar nga të gjithë aktorët që ndikojnë në zhvillimin e turizmit të respektojnë parimet etike në këtë sektor.

Qëllimi i Kodit të Etikës është të ndihmojë në maksimizimin e përfitimit të sektorit të shoqërisë në mbarë globin, duke minimizuar, në anën tjetër, impaktin negativ në mjedis, në trashëgiminë kulturore dhe në ringjalljen e turizmit, në mënyrë që të reformohen të gjitha këto aktivitete.

Aktualisht, ndërsa bota është duke u përballur me pandeminë COVID, pandemi e cila ka goditur sektorë të ndryshëm të shoqërisë, rezulton se turizmi është një nga më të prekurit dhe në një përqindje ndërkombëtare bie në 74% krahasuar me periudhën para pandemisë, pothuaj 1 miliard turistë ndërkombëtarë kanë reshtur së udhëtuar, duke sjellë rrezikimin e punës së mbi 100 milionë të punësuarve në sektorin e turizmit, rrezik, i cili është i përbashkët dhe që ndikon në të gjitha shtetet.

Për këtë qëllim, kjo konventë kuadër për etikën në turizëm, UNWTO-në, përbën një bazë të dakordësuar nëpërmjet së cilës shtetet do të unifikojnë mesazhet e tyre dhe do të ndjekin një strategji të përgjegjshme për të rivendosur pikërisht udhëtimet dhe turizëm të qëndrueshëm në të gjithë botën, që si rrjedhojë, patjetër që kjo do të sjellë ndikim edhe në zhvillimin ekonomik të të gjitha shteteve.

Me aderimin në këtë konventë, shtetet tregojnë gatishmërinë e tyre politike për të zbatuar parimet që promovon kjo konventë si dhe tregon një angazhim përfundimtar për të ndërmarrë të drejtat dhe detyrimet sipas kësaj konvente.

Theksojmë se aderimi në këtë konventë nuk sjell detyrime për Republikën e Shqipërisë që të miratojë akte të tjera ligjore apo nënligjore pasi parimet e parashikuara në këtë konventë janë aktualisht të reflektuara në ligje të posaçme Republikën e Shqipërisë, duke qenë se ne jemi pjesë e Kodit Global të Etikës në Turizëm dhe konventa është në përputhje të plotë me të.

Gjithashtu, aderimi i Shqipërisë në këtë konventë dhe protokollin opsional të saj, si një nga vendet anëtare të UNWTO-së vjen edhe si rrjedhojë e faktit që Shqipëria ka nënshkruar Kodin Global të Etikës në Turizëm.

Aderimi në këtë konventë nuk sjell detyrime financiare për shtete, të cilat bëhen pjesë e saj.

Thelbi i kësaj konvente dhe përfshirja e Shqipërisë në këtë konventë lidhet pikërisht me ato mesazhe të përbashkëta, të cilat do të rrisin zhvillim të qëndrueshëm, turizëm të qëndrueshëm për të ndikuar sektorin ekonomik.

Ju faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, zonja Zëvendësministre!

Ministri Klosi, fjala për ju.

**Blendi Klosi** – Faleminderit, zonja kryetare!

Duke vlerësuar gjithçka që paraqiti kolegja Bello, në emër të Ministrisë së Turizmit, kërkoj edhe unë mbështetjen e kolegëve, anëtarë të këtij komisioni, për këtë projektligj, i cili është një projektligj kuadër sa i përket raportit që ne kemi me Organizatën Botërore të Turizmit.

Konventa është miratuar në shtator të vitit 2019. Unë kam pasur nderin të jem në Asamblenë e Përgjithshme të Organizatës Botërore të Kombeve të Bashkuara, kur është miratuar në kulmin e turizmit në vitin 2019 me një optimizëm shumë të madh të të gjithë komunitetit të turizmit për të vazhduar në atë sukses, me mbi 1 miliard turistë ndërkombëtarë, që udhëtonin në botë në atë periudhë, por vlera e asaj vendimmarrjeje i shërben edhe periudhës së fillimit të pandemisë, pasi konventa nuk flet vetëm për sjelljen karshi turizmit, por natyrisht ka në përmbajtjen e saj edhe raportin që duhet të ketë punëdhënësi me të punësuarit në Sektorin e Turizmit, me një armatë shumë të madhe punonjësish në këtë sektor, të cilët sa i përket etikës në punë dhe raportit që kanë me punëdhënësin, mbrohen nga kjo konventë.

Besoj se ne nuk bëjmë asgjë të keqe kur hapim diskutimet dhe futemi në këtë komunitet, pasi realisht Shqipëria sot, ashtu siç edhe konventa i afron vendet anëtare të Organizatës Botërore të Turizmit të jenë pjesë e një rrjeti të përbashkët për promovimin dhe zhvillimin e

turizmit në botë, një rrjet, i cili po rikthehet fuqishëm në një nga zërat kryesorë tashmë në ekonominë e vendeve anëtare të Organizatës Botërore të Turizmit.

Për detajet teknike, besoj se kolegja Bello ishte shumë e qartë dhe i paraqiti të gjitha së bashku.

Mendoj se bëhemi pjesë e një lëvizjeje botërore për të pasur një turizëm me rregulla, një turizëm etik, natyrisht edhe një turizëm, i cili e njuh botën si një të tërë, pa vënë kufizime. Kjo është një nga pikat e konventës dhe ka qenë një debat edhe në asamble për sa i përket raportit etik me çdo turizëm, duke mos njohur njollat e diskriminimit dhe njollat e problematikave sociale dhe barazive të ndryshme në botën e turizmit.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Të falënderoj, ministri Klosi!

A ka diskutime ose pyetje?

Kolegu Çollaku.

**Kreshnik Çollaku** – Unë e dëgjova relacionin e zëvendësministres, por edhe ministri Klosi e shpjegoi më tej dhe të doja të thosha se kam një paqartësi në parim; paqartësia nuk vjen në parimin e asaj që po na thoni, por mbase edhe nga relacioni. Pra, dilema ime është se nuk vjen nga aderimi apo përkrahja e një konvente të tillë, por mbase vjen nga relacioni që ju keni bërë që, në gjykimin tim, është shumë sipërfaqësor.

Keni shpjeguar, më ndjeni, përkufizime të natyrës etike, grupe vendesh të caktuara, por ngelemi këtu. Praktikisht, unë nuk dua të paragjykoj, por dua të kuptoj se çfarë kufizimesh apo çfarë detyrimesh u sjell politikave të zhvillimit të turizmit në Shqipëri në raport me vendet e tjera, se, për shembull, të krahasoni politikat e turizmit në një vend si Shqipëria, që është një sektor ende në nivelet fillestare, me politikat e turizmit që zhvillon Greqia apo Kroacia, kupton që në parime të përgjithshme mund të dakordësojmë se duhet të ketë etikë operatori turistik, por politikat e turizmit që zhvillojnë vende si këto, që përmenda me nevojat që mund të ketë politika e turizmit në vendin tonë, mund të jenë të ndryshme. Unë nuk dua ta paragjykoj si negative këtë gjë, por do të doja që të kuptoja më shumë se çfarë impakti ka kjo direkt në politikat e turizmit, në liritë e zhvillimit të turizmit, në favorizimet e zhvillimit të turizmit. Duke qenë se ky yni është një sektor me shumë potencial, por ende në fazë primitive të zhvillimit apo fare-fare natyrore, nuk e di nëse futja në konventa të tilla do ta kufizonte, do ta vështirësonte apo do ta ndihmonte.

Kështu që prirja për të qenë pjesë e këtyre konventave patjetër që në terminologji apo në parim nuk ka asgjë të keqe, por duhet të futemi më në terren, nëse operatorët tanë do t'i ndihmonte a kufizonte, do ta lejonte zhvillimin në një sektor apo do ta shtrëngonte zhvillimin në një sektor. Ju thashë që nuk e paragjykoj, por në relacionin tuaj kjo gjë nuk kuptohet ende. Unë nuk e kuptoj dot se çfarë bën mirë apo çfarë bën keq; e para.

E dyta, dëgjova se iu referuat një grupi të përcaktuar vendesh, 14 besoj, a ka formacione të tjera, a ka organizma të tjerë alternativë apo të ngjashme që të krahasojmë se cilat, në fund të fundit, i shërbejnë jo vetëm këtij aderimi, por edhe politikave direkte në zhvillimin e sektorit tonë?

Më ndjeni, edhe një herë dua t'ju them se nuk paragjykoj pjesëmarrjen, aderimin, por mbase nga ajo çfarë ju na thatë, jam ende i paqartë se çfarë ofron, çfarë kufizon dhe çfarë kushtëzon. Në këtë drejtim, do të isha në favor të mbështetjes së zhvillimit të turizmit, po zhvillimit të turizmit për Shqipërinë njëherë, pastaj, në rast se na intereson, aderimi në këto lloj konventash. Në fund të fundit, çdo vend ka politikat e veta për të ndjekur, prandaj le të nisemi nga interesi lokal, pastaj të shkojmë tek aderimi rajonal apo global.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, kolegu Çollaku!

Përpara se t'ia jap fjalën ministrit Klosi, kam një koment për të bërë.

E para, se nuk e dëgjova gabim kolegen Bello, tha se nuk do të ketë ndryshime apo nevojë për amendime të kuadrit ligjor të Republikës së Shqipërisë, sepse është plotësisht në linjë me konventën, ndërkohë besoj se aderimi në konventa e lehtëson jetën tonë dhe kuadrin tonë ligjor për t'u zbatuar dhe e kundërta e vështirë të ndodhë.

Urdhëroni, ministri Klosi!

**Blendi Klosi** – Duke qenë se kam pasur nderin të isha në miratimin e kësaj konvente në asamblenë parlamentare në pozicionim e zëvendës-presidentit të asamblesë, mendoj se është pikërisht ajo që ju thatë. Shqipëria, natyrisht, është një vend i vogël, një vend që është në krijimet e sektorit të tij. Unë e them me bindje se ne jemi ende në fillimet e krijimit të industrisë së turizmit në Shqipëri, por është shumë mirë që në këtë moment ne firmosim konventa të përbashkëta me aleatët tanë që, njëkohësisht, janë edhe konkurrentët tanë.

Por ajo që do të thosha është se jo më kot Organizata Botërore e Turizmit ka filluar (se është një organizatë e re edhe ajo) të krijojë konventa, të krijojë marrëveshje kuadër të të gjitha

vendeve anëtare, duke qenë se ne po hyjmë në një botë globale të zhvillimit të turizmit, ku nuk është më turisti që vjen individualisht, por janë struktura të tëra që aderojnë në këtë punë dhe në këtë biznes dhe mosbërja pjesë e disa kodeve etike, kodeve administrative, të disa marrëveshjeve të përbashkëta me vendet anëtare të organizatave të tilla, shpesh, në mënyrë të pakuptimtë na lë jashtë vëmendjes së organizatave të biznesit në botën e turizmit.

Pra, për t'u futur këtu, sepse janë organizata shumëkombëshe, shumë të forta, organizata me buxhete të jashtëzakonshme dhe ata duan që, kur të bëjnë biznes me një vend si Shqipëria, Shqipëria të jetë pjesë e disa marrëveshjeve të përbashkëta me vendet e tjera që njohin dhe respektojnë, të paktën parimisht ato konventa, siç është konventa e etikës në turizëm. Siç jua thashë, në asamble pati diskutim shumë të madh për mosdiskriminimin racor, mosdiskriminimin e komuniteteve të caktuara dhe në politikat e kompanive të mëdha që bëjnë biznes, një nga pikat është edhe pjesëmarrja në këto konventa.

Ky është shpjegimi për atë çfarë ju kërkua, pra pse ne duhet të jemi pjesë e këtij komuniteti. Natyrisht që janë vetëm 14 vende dhe në asamble nuk pati asnjë votë kundër, por menjëherë pas kësaj filloi pandemia dhe u bllokua i gjithë aktiviteti i botës së turizmit, si dhe aktiviteti i Organizatës Botërore të Turizmit dhe kjo është arsyeja e vetme që s'kanë avancuar aktivitetet e saj për të pasur më shumë aktivitete të përbashkëta, për të pasur më shumë firma në këtë konventë.

Edhe tema është e atillë që është e vështirë të ketë kundërshtarë. Natyrisht, nuk mendoj që të ketë kundërshtarë të kësaj konvente as në parlamentin shqiptar, por as në të gjithë botën e turizmit apo në shtetet të cilat bëjnë pjesë.

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, ministër!

Urdhëroni, zëvendësministre!

**Vilma Bello** – Duke e falënderuar për komentet dhe shpjegimin relatorin, doja të theksoja që brenda kësaj konvente të flasim më shumë jo thjesht për politika të zhvillimit të turizmit, sepse, ashtu siç tha edhe relatori Klosi, janë pikërisht disa parime të përgjithshme, të cilat Shqipëria, si një vend në zhvillim në industrinë e turizmit, do të ishte mirë që të ishte pjesë.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, Zëvendësministre!

Urdhëroni, kolegu Çollaku!



**Kreshnik Çollaku** – Në fakt, mbase nuk doli mirë ajo çfarë thashë. Unë nuk kam problem me çështjen e aderimit në konventë, çështja është e sqarimit, që të kuptoj se çfarë efektesh apo kundërefektesh do të sillte eventualisht. Pra, e thënë troç, unë nuk e kam me aderimin në konventë, por me sqarimet tuaja, kështu që mund ta pranoni edhe si kritikë, mbase mund të ishin më të thelluara.

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, kolegë!

Këtu e mbyllim diskutimin për këtë projektligj dhe e hedhim në votim.

Kush është dakord në parim me projektligjin?

Shikoj që jemi të gjithë dakord.

Ju faleminderit për bashkëpunim, kolegë!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Neni 1.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet!

Neni 2.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet!

E votojmë projektligjin në tërësi.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet!

Të gjithë jemi dakord.

Faleminderit, kolegë, për bashkëpunimin!

Faleminderit, Zëvendësministre për prezencën!

Punë të mbarë!



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Politikën e Jashtme***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 26.01.2022, ora 12:00

**Drejton mbledhjen:**

**Mimi Kodheli – kryetare e Komisioni**

**Rendi i ditës**

Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën ndërkombëtare për kontrollin e dëmit nga sistemet për mbrojtjen antivegjetative në anije (*anti-fouling*) 2001”.

**Marrin pjesë:**

Mimi Kodheli, Etjen Xhafaj, Petro Koçi, Besjon Ajazi, Blendi Klosi, Tomor Alizoti, Hatixhe Konomi, Klodiana Spahiu, Lavdrim Krrashi, Belind Këlliçi, Kreshnik Çollaku, Vangjel Dule, Grida Duma, Taulant Balla.

**Mungojnë:**

Benet Beci, Alqi Bllako, Tritan Shehu, Shpëtim Idrizi dhe Greta Bardeli.

**Të ftuar:**

Ardi Veliu – Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Bledar Karoli – Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Transportit

Elson Thana – Specialist në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Transportit

**Mimi Kodheli** – Kalojmë te projektligji i dytë “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën ndërkombëtare për kontrollin e dëmit nga sistemet për mbrojtjen antivegetative në anije (*anti-fouling*) 2001”.

Jemi komision për dhënie mendimi.

Relaton kolegia Konomi.

Ndërkohë, të ftuar kemi zotin Veliu, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, zotin Karoli, përgjegjës Sektori, në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Transportit dhe zotin Thana, specialist pranë kësaj drejtorie dhe zoti Solis, specialist pranë së njëjtës drejtori, mungon sot për shkak të COVID-it.

Urdhëroni zoti Veliu!

**Ardi Veliu** – E nderuar kryetare,

Projektligji që po paraqesim sot “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën ndërkombëtare për kontrollin e dëmit nga sistemet për mbrojtjen antivegetative në anije (*anti-fouling*) 2001”.

Sistemet *anti-fouling* janë lëndë që shërbejnë për lysterjen e fundit të anijes, me qëllim parandalimin e ngjitjes së gjallesave bimore si alga dhe molusqe, të cilat ndikojnë ndjeshëm në uljen e shpejtësisë së anijeve, rritjen e konsumit të karburantit dhe ndotjen e ajrit.

Në periudhat e hershme anijet për të mos lejuar ngjitjen e gjallesave në pjesën e poshtme të tyre, kanë përdorur lëndë helmuese si arseniku apo lëndë të tjera, të cilat, përveç algave dhe molusqeve, dëmtonin edhe mjedisin ujor, duke ndikuar në mënyrë negative në zinxhirin ushqimor të gjallesave detare dhe në biodiversitet.

Duke pasur parasysh rrezikun, i cili sa po vinte dhe po shtohet, Organizata Ndërkombëtare Detare (IMO) për një periudhë të gjatë dhe në mënyrë intensive ka nxitur kërkimet në industrinë kimike për gjetjen e një sistemi, i cili nuk do të lejonte ngjitjen e gjallesave në fundin e anijeve dhe nuk do të ishte i dëmshëm për mjedisin.

Pas një pune të gjatë në fushën e shkencës, në muajin nëntor të vitit 1999 IMO-ja filloi punën për hartimin e një instrumenti ligjor të zbatueshëm për të gjitha shtetet e saj anëtare, me qëllim adresimin e efekteve të dëmshme në sistemin *anti-fouling* të përdorur në anije.

Në vitin 2003 IMO-ja, me anën e një rezolute u bëri thirrje gjithë shteteve anëtare të ndalojnë dhe kufizojnë përdorimin e sistemeve të dëmshme ndaj mjedisit në anijet që mbajnë flamurin e tyre, si dhe në anijet që nuk mbajnë flamurin e tyre, por që operojnë nën autoritetin e

tyre dhe të gjitha anijet që hyjnë në një port, kantier detar ose terminal në det të hapur në një shtet anëtar.

Më pas kjo rezolutë u quajt konventa ndërkombëtare për kontrollin e dëmit nga sistemet antivegetative *anti-fouling* 2003, e cila po trajtohet sot si projektligj.

Projektligji është në përputhje me programin e qeverisë, i cili në kapitullin “Integrimi në Bashkimin Europian” përcakton se zbatimi me korrektësi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), përmbushja e pjesës së mbetur nga 12 prioritetet e Planit të Veprimit, janë elemente kryesorë për cilësinë dhe shpejtësinë e procesit të aderimit të Shqipërisë në BE. Miratimi i projektligjit është parashikuar si një nga angazhimet e ministrisë përgjegjëse për transportin në Strategjinë Sektoriale të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016-2020, miratuar me VKM-në nr. 811, datë 16.11.2016, në të cilën është përcaktuar “Përmirësimi i sistemit rregullator detar në pajtim me standardet dhe rregulloret e IMO-së dhe BE-së” dhe “Ratifikimi dhe nënshkrimi i rregulloreve të IMO-së dhe BE-së mbi sigurinë e parrezikshmërinë detare, mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin bregdetar”.

Për zbatimin e këtij projektligji nuk ka efekte financiare.

Sa më sipër, duke ju falënderuar paraprakisht për mirëkuptimin, kërkojmë bashkëpunimin tuaj që të miratojmë këtë projektligj të rëndësishëm për Republikën e Shqipërisë.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit!

Urdhëroni, kolegja Konomi!

**Hatixhe Konomi** – Faleminderit, kryetare!

Republika e Shqipërisë është anëtare e Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të drejtën e detit që prej vitit 1982 dhe, si e tillë, ka detyrimin të ruajë dhe të mbrojë mjedisin e saj detar. Po ashtu, është anëtare e Organizatës Ndërkombëtare Detare IMO dhe pikërisht projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën ndërkombëtare për kontrollin e dëmit nga sistemet për mbrojtjen antivegetative në anije (*anti-fouling*) 2001”, propozuar sot nga Këshilli i Ministrave, përcakton detyrimet që ka Republikës së Shqipërisë si anëtare e Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO) për aderimin në të gjitha konventat ndërkombëtare në fushën e detarisë, ndryshimeve të tyre dhe rezolutave të IMO për plotësimin e standardeve ndërkombëtare në fushën e detarisë.

Në kontekstin e përgjithshëm të zhvillimit, patjetër që roli i anijeve është shumë i rëndësishëm, me një kontribut të jashtëzakonshëm në tregtinë globale, por natyrisht, ashtu siç kanë edhe kontributin, kanë edhe një ndikim sado minimal në mjedisin global dhe atë detar dhe është pikërisht IMO-ja, si një agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara me përgjegjësi për sigurimin e transportit detar, e cila i trajton rastet e ndotjes nga anijet, duke marrë edhe një gamë të gjerë të masave për parandalimin dhe kontrollin e ndotjes së shkaktuar nga anijet.

Pikërisht, në mënyrë të veçantë më 18 tetor të vitit 2001, u mbajt një konferencë prej së cilës u miratua edhe konventa ndërkombëtare për kontrollin e dëmit nga sistemet për mbrojtjen antivegetative në anije 2001 dhe është pikërisht ky projektligj që ne po e diskutojmë këtu, i cili synon ratifikimin e kësaj marrëveshjeje dhe ka për qëllim të reduktojë ose të eliminojë efektet negative në mjedisin detar e shëndetin e njeriut të shkaktuar nga sistemet e mbrojtjes antivegetative për anijet.

Pa dashur të zgjatem shumë në detajet teknike, sepse, edhe po të doja nuk do të mundja se nuk jam person teknik, këtë e bën më së miri përfaqësuesi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe të Energjisë, unë do të doja të ritheksoja edhe një herë se sa e rëndësishme e sfiduese mbetet sot për çdo vend të planetit mbrojtja e mjedisit, në mënyrë të veçantë e mjedisit detar.

Prej vitesh studimet shkencore kanë treguar se disa sisteme për mbrojtjen antivegetative për anijet, të përdorura prej tyre, paraqesin rrezik të konsiderueshëm të lëndëve toksike dhe ndikime të tjera kronike për organizmat detarë të rëndësishëm në aspektin ekologjik dhe ekonomik dhe, gjithashtu, dëmtohet shëndeti i njeriut si rezultat i konsumit të ushqimeve të detit të prekur. Konferenca e Kombeve të Bashkuara për mjedisin dhe zhvillimin 1992 u bën thirrje shteteve të marrin masa për të reduktuar ndotjen e shkaktuar nga komponimet organike të përdorura në sistemet e mbrojtjes antivegetative për anijet (*anti-fouling*).

Sipas kushteve të konventës AFS, palëve në konventë u kërkohet të ndalojnë dhe/ose të kufizojnë përdorimin e sistemeve të dëmshme anti-ndotje në anijet që mbajnë flamurin e tyre, si dhe anijet që nuk kanë të drejtë të mbajnë flamurin e tyre, por që veprojnë nën autoritetin e tyre dhe të gjitha anijet që hyjnë në një port, kantier detar ose terminal në det të një pale.

Konventa ndalon përdorimin e organotinave të dëmshme në bojërat kundër ndotjes të përdorura në anije dhe vendos një mekanizëm për të parandaluar përdorimin e mundshëm të substancave të tjera të dëmshme në të ardhmen në sistemet anti-ndotje.

Sa u takon efekteve financiare, zëvendësministri u shpreh që ky projektligj nuk sjell efekte financiare për buxhetin e shtetit.

Për sa më sipër, të nderuar kolegë, unë do t'ju ftoja të gjithëve që ta mbështesim dhe ta votojmë këtë projektligj!

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, kolegja Konomi!

A ka pyetje ose diskutime?

Urdhëroni, kolegu Xhafaj!

**Etjen Xhafaj** – Faleminderit, kryetare!

Faleminderit, Zëvendësministër për prezantimin tuaj!

Unë kisha vetëm një pyetje në lidhje me implementimin e konventës, pra si do të kontrollohet si për mjetet lundruese që kanë flamur shqiptar, si për ato që vizitojnë portet e Shqipërisë dhe mbajnë flamurë të vendeve të tjera?

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, kolegu Xhafaj!

Urdhëroni, nënkryetar Alizoti!

**Tomor Alizoti** – Unë do ta kapërcej pak temën e anijeve, por prita momentin, meqë kemi të bëjmë me Ministrinë e Infrastrukturës.

Unë propozoj që, ne si Komision i Jashtëm, të shkëputem pak nga tema e vëmendjes që të marrim një rezolutë në lidhje me Ukrainën. Jam jashtë teme, por dua ta bëj, se nuk kam hapësirë tjetër.

**Mimi Kodheli** – Ta diskutojmë në fund. Dakord.

Edhe unë kisha një pyetje për ju: a ka nevojë për ndryshime të tjera ligjore miratimi i aderimit në këtë konventë?

**Ardi Veliu** – Faleminderit!

Po e nis nga pyetja e fundit. Nuk do të ketë ndryshime ligjore, por do të ketë ndryshime të disa akteve ose udhëzimeve, të cilat do të bëhen në bashkëpunim edhe me IMO-n, edhe me strukturat e tjera të BE-së.

Pra, nuk do të ketë ndërhyrje në ligj, por do të ketë disa udhëzime, të cilat do të normojnë aktivitetin.

Për sa i përket pyetjes së parë në lidhje e inspektimet, theksoj se tashmë janë të trajnuara të dyja strukturat të cilat do të merren me dhënien e certifikatës *anti-fouling* në anijet me flamur të huaj që kryejnë aktivitetet në vendin tonë dhe ato do të jenë nga Kontrolli Shtetëror Portual, ndërsa për anijet me flamur shqiptar do të jetë nga Kontrolli Shtetëror i Flamurit.

**Mimi Kodheni** – Kolegia Duma.

**Grida Duma** – Sipas relacionit, ju thatë që nuk do të ketë efekte financiare në buxhet.

A do të ketë efekte financiare për vetë administruesit e sektorit?

Në rastet e mosrespektimit, kur hyn në fuqi ligji, cilat janë masat ndëshkuese pas inspektimit?

Lexoj në relacion se edhe në raste vonesash për inspektim do të ketë një kompensim për anijet. Sa do të jetë masa e kompensimit? Si është llogaritur masa e kompensimit? Pra, cilat janë efektet financiare, pavarësisht se nuk janë nga buxheti i shtetit, por për operatorët që janë të sipërmarrjes së lirë?

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit!

Para se t'ua jap fjalën përfaqësuesve të ministrisë, unë mendoj se aderimi i konventës është vetëm fillimi i çdo amendimi ose udhëzimi që do të jepet, kështu që nuk besoj se do të ketë një kalkulim të mëvonshëm të të gjitha kostove ekstra që do të kenë përdoruesit e anijeve në çdo rast apo edhe të sanksioneve që do të vërë qeveria, më korrigjoni nëse nuk jam e saktë.

A keni ndonjë koment për të shtuar?

Zëvendësministër, para se te ndërhyri, fjala është për kolegun Koçi.

**Petro Koçi** - Kjo konventë bën fjalë për standarde më shumë teknike, *antifouling*, por që poseduesit e mjeteve mund të jenë hileqarë në përdorimin e atyre lëndëve që përdorin për të lyer tabanin e poshtëm të mjeteve. Pra, përtej konventës, a e parashikojnë këtë lloj përcaktimi standardet e deritanishme nga pikëpamja ligjore ose administrative, apo kjo vjen për herë të parë si standard?

**Mimi Kodheli** – Po, zoti Veliu.

**Ardi Veliu** – Lidhur me efektet financiare, siç u përmend edhe pak më parë, ato janë zero sa i përket buxhetit të shtetit, ndërsa sa u përket praktikave të operatorëve, të cilët janë në treg, pa dyshim në çdo kohë këta ua kalojnë inspektimeve periodike, që bëhen në porte. Në rast se këto do të konstatohen, do të kenë penalitete sa i përket bllokimit të mjetit, në rastin konkret

të anijeve. Aktualisht, kjo është duke u praktikuar, por ne, si anëtarë të IMO-s, duhet të miratojmë aderimin në konventë.

**Elson Thana** - Në vijim të fjalës së zëvendësministrit, dua t'ju bëj me dije se me të vërtetë në këtë konventë po aderojmë për t'u bërë pjesë e saj, por aktualisht të gjitha anijet, duke qenë se kryejnë aktivitet ndërkombëtar janë të detyruara t'i zbatojnë këto rregulla, aktualisht i zbatojnë këto rregulla dhe nuk ka ndonjë efekt edhe për ata. Pra, detyrimi për të zbatuar me përpikëri këto rregulla i kanë kantieret detare. Ne normalisht nuk kemi kantiere detare që të lyejmë anijet, por ato bëhen jashtë shteti dhe atje e kanë me detyrim që të gjitha llojet, lëndët që përdorin për të lyer anijet janë të certifikuara brenda listës së parashikuar nga konventa, që do të thotë se nuk mund të vendosin, nuk mund të bëjnë hile të përdorin një lëndë tjetër jashtë konventës, sepse edhe ata kanë inspektimet e tyre. Për monitorimin e kësaj çdo kantier në momentin që lëshon bojën bën lëshimin e certifikatës dhe lëshimi i certifikatës monitorohet nga institucionet tona që i kemi në terren, si për portin, ashtu edhe për anijet që janë me flamur shqiptar. Kështu që, kjo situatë është e monitoruar, por pas miratimit dhe aderimit në konventë fillojmë me akte të tjera që janë zbatuese, që janë disa udhëzues për të treguar si do të veprojnë operatorët, por edhe institucionet shtetërore për monitorimin e këtij aktiviteti. Aktualisht në i bëjmë, por do t'i japim karakter juridik të veprimeve.

Në momentin që do të aderojmë, kemi parashikuar që organizatat ndërkombëtare detare edhe Komisioni European kanë një set trajnimesh dhe asistencë teknike, që do të vijjnë në vitin 2022 dhe të trajnojnë efektivet tanë, por do të na ndihmojnë në plotësimin e kuadrit ligjor. Ne nuk kemi kantiere për lyerje.

**Mimi Kodheli** - Kalojmë në votim.

Kush është dakord në parim me aderimin në këtë konventë? Dakord. Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Miratimi në tërësi. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.



Faleminderit për bashkëpunimin, kolegë dhe të ftuar!



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Politikën e Jashtme***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 26.01.2022, ora 11:30

**Drejton mbledhjen:**

**Mimi Kodheli – kryetare e Komisioni**

**Rendi i ditës:**

Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën “Për Organizatën Hidrografike Ndërkombëtare””.

**Marrin pjesë:**

Mimi Kodheli, Etjen Xhafaj, Petro Koçi, Besion Ajazi, Blendi Klosi, Tomor Alizoti, Hatixhe Konomi, Klodiana Spahiu, Lavdrim Krashi, Belind Këlliçi, Kreshnik Çollaku, Vangjel Dule, Grida Duma dhe Taulant Balla.

**Mungojnë:**

Benet Beci, Alqi Bllako, Tritan Shehu, Shpëtim Idrizi dhe Greta Bardeli.

**Të ftuar:**

Dallëndyshe Bici – Zëvendësministre e Mbrojtjes

Ardit Çollaku - Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Fushën e Mbrojtjes

Emërush Bejdo - Komandant i Hidrografisë në Komandën e Forcës Detare, Kapiten i Rangut të Parë.

**Mimi Kodheli** - Kalojmë te projektligji i fundit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën “Për Organizatën Hidrografike Ndërkombëtare””. Relator është kolegu Koçi. Ne jemi komision për dhënie mendimi. Për të diskutuar për këtë projektligji kemi të ftuar zonjën Bici, zëvendësministre e Mbrojtjes, zotin Çollaku, drejtor i Rregullave dhe Përputhshmërisë në Fushën e Mbrojtjes, Kapiten i Rangut të Parë, dhe zotin Emërush Nejdó, Komandant i Hidrografisë në Komandën e Forcës Ajrore.

Zonja Bici, keni fjalën.

**Dallëndyshe Bici** – Faleminderit!

E nderuar kryetare e komisioni,

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Sot Ministria e Mbrojtjes prezanton para jush një projektligj për aderimin e Shqipërisë në Organizatën Ndërkombëtare Hidrografike, e themeluar që në vitin 1921 dhe që në këtë vit ajo ka pasur si mision lehtësimin e procedurave, sigurimin e informacionit hidrografik për mbarë botën për qëllime lundrimi ose të tjera nëpërmjet bashkërendimit të punës me shërbimet hidrografike kombëtare të secilit vend anëtar. Nisma për aderimin e Republikës së Shqipërisë në këtë organizatë është e Ministrisë së Mbrojtjes, së bashku me institucionin që do të jetë në vijë të parë në zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo konventë, që është shërbimi Hidrografi i Komandës së Forcave Detare, të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Ajo që është e rëndësishme për përfitimin e Shqipërisë në aderimin në këtë organizatë është ruajtja dhe zhvillimi i kapaciteteve teknike dhe atyre njerëzore, ndikimet në sigurinë e ekonomisë detare, ndikimi në zhvillimin ekonomik, zgjerimi i marrëdhënieve shumëpalëshe me shtete aleate të rajonit dhe më gjerë.

Anëtarësimi në këtë organizatë do të na mundësojë plotësimin e suksesshëm të kuadrit ligjor në fushën e detarisë, hidrografisë për t'i mundësuar Shqipërisë një ambient më të sigurtë, më të zhvilluar në fushën e mbrojtjes, po ashtu edhe në fushën e turizmit ose në fusha të tjera. Bashkë me përfitimet ky proces mbart edhe detyrime financiare, detyrimi për anëtarësim është 8 mijë euro, i cili do të përballohet nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes për 2022. Kjo shumë është llogaritur mbi bazën e tonazhit të Flotës Detare dhe anijeve tregtare, të cilat ne arrijmë në 100 tonë.

Përfitimet ekonomike të Shqipërisë nga shfrytëzimi i qëndrueshëm i ekonomisë blu dhe shitja e hartave detare qoftë ato elektronike ose në letër si edhe botimet e tjera hidrografike që do të jenë të mjaftueshëm për të justifikuar shpenzimet e anëtarësimit në këtë organizatë.

Me dëshirën për të vazhduar bashkëpunimin mbi bazë qeveritare në hidrografi, si edhe për të gjitha arsyet e mësipërme, Ministria e Mbrojtjes propozon dhe mbështet anëtarësimin e vendit tonë në këtë organizatë ndërkombëtare.

**Mimi Kodheli** – Faleminderit!

Do të bëj një korigjim, zoti Nejdo, kapiteni i rangut të parë, është Komandanti i Hidrografisë në Komandën e Forcës Detare, jo ajrore, pavarësisht se nga ministria juaj e ka ardhur Forcave Ajrore, por unë si ish- ministre gjatë leximit e korigjova vetë këtë.

Zoti Koçi.

**Petro Koçi** – Aderimi në këtë konventë që është bazë, është si statut i Organizatës Ndërkombëtare të Hidrografisë. Unë mendoj se është një hap institucional shumë i rëndësishëm, sepse i jep një garanci shumë të madhe për lundrimin e sigurtë në hapësirën detare të Shqipërisë. Vitet e fundit Shërbimi Hidrografik i Forcave të Armatosura është përforcuar dhe mendoj se ky hap është i rëndësishëm, sepse dihet që një lundrim i sigurt, është një garanci e mëtejshme për zhvillim të gjithanshëm ekonomik, sepse ashtu, siç u tha ekonomia blu, në turizëm transport detar, qoftë të mallrave ose të njerëzve. Sigurisht nga pikëpamja institucionale garanton marrëdhënie intensive me homologët që janë pjesë e kësaj organizate. Dihet se kjo organizatë ka rolin e vëzhguesit në Kombet e Bashkuara, ngritja e saj daton që nga viti 1921, dhe gati pas 100 vjetësh bëhemi pjesë e saj, por me mirë vonë se kurrë. Dihet që hartografia nënujore e Shqipërisë nuk ka qenë e plotë dhe Shërbimi Hidrografik i viteve të fundit e ka bërë të mundur që ne të kemi tashmë një hartë më të plotë të tabanit detar, sepse shërben shumë për të gjithë operatorët e lundrimit detar. Shpeshherë Shqipëria është identifikuar në hartën ndërkombëtare si një hapësirë detare me problematikë, kështu që tani dihet ka mbetje të Luftës së Dytë Botërore e të tjera. Përveçse një hartografi e thjeshtë, kjo sjell edhe nevojën për pastrim nga mbetjet e rrezikshme, kështu që unë e mbështes plotësisht këtë projektligj që ka ardhur nga qeveria dhe ftoj të gjithë kolegët ta miratojmë me konsensus, sepse është aset më shumë, një hapësirë më shumë për Forcat tona të Armatosura për ndërveprim në fushën e hidrografisë.

Faleminderit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë kam një përvojë personale, sepse kur kemi marrë si Ministri e Mbrojtjes kapacitet të rëndësishëm nga partnerë për të zhvilluar më tej Shërbimin Hidrografik kam qenë prezent dhe kujtoj me shumë nostalgji atë moment. Besoj se ai skafi hidrografik ka bërë shumë punë që nga ai moment dhe deri tani.

Faleminderit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Mimi Kodheli** – Unë besoj se do ta mbyllim. Nëse nuk ka komente ose diskutime ta hedhim në votim. Për Ministrinë e Mbrojtjes nuk është ndonjë shumë e madhe 8 mijë euro.

Kalojmë në votimin në parim. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.  
Miratohet.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.  
Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.  
Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.  
Miratohet.

Faleminderit!

**Dallëndyshe Bici** – Faleminderit, kryetare, por ky është një proces që ka nisur shumë herët dhe prandaj ne ju falënderojmë ju.

## **MBYLLET MBLEDHJA**